



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 382 Akti

Nr. 385 Vendimi
Tiranë, më 18.5.2021

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Pamela Qirko	Kryesuese
Etleda Çiftja	Relatore
Roland Ilia	Anëtar

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Olsida Goxhaj, në prezencë edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Elka Ermenkova, në datën 17.5.2021, ora 14:00, dhe në datën 18.5.2021, në Pallatin e Koncerteve, (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mbylli seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Flojera Davidhi, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë.**

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së dhe nenet Ç, D, DH, E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;**

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, komisionere Etleda Çiftja, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, dëgjoi subjektin e rivlerësimit, znj. Flojera Davidhi, dhe pasi shqyrtoi në tërësinë e saj çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit, i cili në seancën dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT PROCEDURALE

1. Znj. Flojera Davidhi është subjekt i rivlerësimit për shkak të funksionit të saj si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, ‘Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë’, të ndryshuar”, dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016).

2. Znj. Flojera Davidhi, bazuar në nenin 14 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit, duke u shortuar në datën 16.12.2019 me trupin gjykues të përbërë nga komisioneret: Pamela Qirko, Etleda Çiftja dhe Roland Ilia.

3. Menjëherë pas hedhjes së shortit u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), sipas neneve 31 - 33 të ligjit nr. 84/2016; Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK), sipas neneve 34 - 39 të ligjit nr. 84/2016; dhe më tej nga Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ), sipas neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016.

4. Trupi gjykues i shortuar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (në vijim Komisioni), me vendimin datë 13.1.2020, pas studimit të raporteve të sipërpërmendura të vlerësimit të hartuara nga institucionet shtetërore, vendosi të fillojë hetimin administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, si dhe të caktojë kryesuese të trupit gjykues, komisioneren Pamela Qirko. Të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit.

5. Në datën 13.1.2020, përmes postës elektronike¹, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi vendimin e trupit gjykues, datë 13.1.2020, për fillimin e procesit të rivlerësimit, e njoftoi mbi përbërjen e trupit gjykues dhe i kërkoi subjektit të deklaronte nëse gjendej në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues. Komisioni gjithashtu i kërkoi subjektit informacion shtesë sipas pyetësorit standard.

6. Trupi gjykues, me vendimin, datë 7.5.2021, vendosi: (i) të përfundojë hetimin paraprak për subjektin e rivlerësimit, znj. Flojera Davidhi, bazuar në relatimin mbi rezultatet e hetimit të paraqitur nga relatori i çështjes; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit kryesisht sipas ligjit nr. 84/2016, të drejtën për të paraqitur prova/shpjegime me shkrim në lidhje me rezultatet e hetimit; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe me nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative; (iv) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarit, si dhe me afatin brenda të cilit mund t’i ushtrojë këto të drejta.

¹ E-mail datë 13.1.2020, ora 16:44 “Njoftim për fillimin e procesit të rivlerësimit dhe kërkesë për informacion shtesë”.

7. Në datën 7.5.2021, përmes postës elektronike², trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) kalimin e barrës së provës, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe të sjellë prova për të provuar të kundërtën, jo më vonë se data 18.12.2020; si dhe (iii) njohjen me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe me nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative. Në këtë njoftim, subjekti iu kërkua të paraqiste prova dhe shpjegime brenda datës 14.5.2021.

8. Në datën 12.5.2021 subjekti i rivlerësimit paraqiti pretendimet e saj me shkrim dhe dokumentacionin justifikues bashkëlidhur pretendimeve në lidhje me rezultatet e hetimit kryesisht me anë të postës elektronike³.

9. Më tej, Komisioni njofton subjektin e rivlerësimit me anë të postës elektronike⁴ se trupi gjykues, me vendimin e datës 12.5.2021, vendosi të ftojë për t'u dëgjuar në seancën dëgjimore lidhur me rezultatet e hetimit për vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, në datën 17.5.2021, ora 14:00, bazuar në nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", si dhe në Kodin e Procedurave Administrative.

10. Bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, znj. Flojera Davidhi, bazuar në të tria kriteret e rivlerësimit: vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës, si dhe vlerësimi i aftësive profesionale.

II. SEANCA DËGJIMORE

11. Në datën 17.5.2021 u zhvillua seanca dëgjimore në prezencë të subjektit të rivlerësimit dhe në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Elka Ermenkova, në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht në seancë.

12. Relatori i çështjes paraqiti rezultatet e arritura nga Komisioni përgjatë fazës së hetimit administrativ, të kryer mbi të tria kriteret e rivlerësimit dhe të kaluara si barrë prove apo për shpjegime.

13. Znj. Flojera Davidhi, pasi dëgjoi relacionin, shprehu qëndrimin e saj, duke parashtruar shpjegimet përkatëse lidhur me gjetjet e hetimit kryesisht, si dhe mbi procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj.

14. Në përfundim të seancës dëgjimore, bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi ta konsiderojë të plotësuar procesin e rivlerësimit për subjektin Flojera Davidhi, duke u bazuar mbi të tria kriteret e rivlerësimit.

15. Seanca dëgjimore e datës 17.5.2021 u ndërpre, për të rifilluar në datën 18.5.2021, për shpalljen e vendimit.

² E-mail datë 7.5.2021, ora 15:16, "Komisioni – Njoftim mbi përfundimin e hetimit kryesisht për procesin tuaj të rivlerësimit".

³ E-mail datë 12.5.2021, ora 9:50, "Shpjegime në lidhje me rezultatet e hetimit në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar-Flojera Davidhi".

⁴ E-mail datë 12.5.2021, ora 16:33, "Komisioni – Ftesë për seancë dëgjimore publike".

16. Në përfundim të seancës dëgjimore të datës 18.5.2021, subjekti i rivlerësimit, znj. Flojera Davidhi, kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

17. Subjekti i rivlerësimit, znj. Flojera Davidhi, ka qenë bashkëpunuese gjatë gjithë procesit, në përputhje me nenin 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

18. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, i cili mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.

19. Sipas krerëve IV, V dhe VI të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”: (i) ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të paraqitur një raport me konstatime në lidhje me vlerësimin pasuror. (ii) DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, duke paraqitur në Komision një raport me konstatimin në lidhje me përshtatshmërinë apo papërshtatshmërinë e subjekti të rivlerësimit; (iii) KLGJ-ja është organi ndihmës për vlerësimin profesional, i cili në përfundim të shqyrtimit të dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe pesë dokumenteve të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, përgatit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar.

20. Referuar vendimit nr. 2/2017⁵ të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, Komisioni realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, i cili nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

A. RIVLERËSIMI I PASURISË

A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

21. ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar⁶, pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, znj. Flojera Davidhi, që është bërë subjekt deklarues në

⁵ Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas pikës 5, të nenit 179/b, të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni, kurse sipas nenit 4/2, të ligjit nr. 84/2016: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit nr. 84/2016, parashikohet se: “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII, të ligjit nr. 84/2016, rezulton se: “Në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

⁶Me shkresën nr. ***, datë 29.5.2018.

ILDKPKI në vitin 2013, dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar.

22. Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar deklaratat e interesave private për vitet 2013 - 2016. Nga verifikimi i datës së dorëzimit të deklaratës së pasurisë *Vetting* në zbatim të nenit 31/1⁷, rezulton se subjekti Flojera Davidhi, me nr. indeksi ***, e ka dorëzuar deklaratën e pasurisë (duke përfshirë personat e lidhur) në bazë të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në datën 28.1.2017, dhe ky fakt konfirmohet nga ILDKPKI-janë përmjet vërtetimit të lëshuar. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja, për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur, është konstatuar:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin, ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për burimin e depozitës;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

23. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni hetoi dhe vlerësoi të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI në “Deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, *Vetting*”, të vitit 2017; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratat vjetore të deklarimit të pasurisë në ILDKPKI, nga fillimi i detyrës deri në vitin 2016; (ç) provat shpresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (d) deklarinimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik; si dhe (dh) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit, e në vijim, deri ditën e seancës dëgjimore, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

24. Komisioni hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me ligjin nr. 84/2016, hetim i cili konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe të personave të lidhur; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe të shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose në përdorim; dhe (iv) evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuar nga pika 5 e nenit 33 e ligjit nr. 84/2016.

⁷Subjekti i rivlerësimit ka detyrimin të plotësojë deklaratën e pasurisë, sipas shtojcës 2 të ligjit, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi dhe e dërgon atë pranë ILDKPKI-së.

Në lidhje me pasuritë dhe likuiditetet e deklaruara në deklaratën e pasurisë *Vetting* të vitit 2017, nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur, janë deklaruar:

1. Tokë bujqësore me sip. 16.429 m², në fshatin G., Lushnjë

25. Në deklaratën *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “*Tokë bujqësore, fituar me ligjin nr. 7501, ‘Për tokën’, me sipërfaqe totale 16.429 m², ndodhur në fshatin G., Lushnjë, dhënë me aktin e marrjes së tokës në pronësi, me nr. ***, datë 4.3.1993 (pa regjistruar në regjistrat publikë). Për shkak të mosregjistrimit nuk kemi bërë vlerësimin në lidhje me vlerën që ka kjo pronë. Pjesa takuese: 1/3*”. Si burim krijimi subjekti ka deklaruar: *dhënë me aktin e marrjes së tokës në pronësi, me nr. ***, datë 4.3.1993, me ligjin nr. 7501, “Për tokën”*. Për vërtetimin e deklarimeve, subjekti ka paraqitur dokumentacion ligjor provues⁸.

26. Faktet nga hetimi administrativ kryesisht – në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës të vitit 2013, subjekti ka deklaruar *tokë bujqësore, marrë me ligjin nr. 7501, ndodhur në G., komuna G., Lushnjë, me sip. 16.000 m², pjesa takuese: 1/3 (e paregjistruar në regjistrat publikë)*.

27. Subjekti ka dorëzuar në deklaratën *Vetting* AMTP-në nr. *** akti, datë 4.3.1993, lëshuar në emër të shtetasit M.N.D., ku i jepet në pronësi sipërfaqja prej 16.429 m² dhe 170 m² në përdorim, në fshatin G., Lushnjë, si dhe vendimin nr. ***, datë 25.6.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, për çeljen e trashëgimisë, pas vdekjes së babait M.D., duke përcaktuar trashëgimtarët ligjorë, D.D., Flojera Davidhi dhe F.D. (vëllai), me 1/3 pjesë të pasurisë.

28. Në procesverbalin e mbajtur pranë ILDKPKI-së në datën 17.9.2014, subjekti është pyetur lidhur me deklarimin e kësaj pasurie në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës dhe shpjegon se familja bujqësore në atë kohë përbëhej nga 4 anëtarë (prindërit, subjekti dhe vëllai), ku secilit anëtar i përkisnin afërsisht 4.000 m², trashëguar pjesa takuese.

29. Nga hetimi i Komisionit, rezulton se sipas ASHK-së Lushnjë⁹ subjekti i rivlerësimit Flojera Davidhi dhe shtetasja D.D. (nëna e subjektit) kanë të regjistruar pasurinë e llojit “arë”, me sip. 5.420 m², me nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, në fshatin G., Lushnjë.

30. Referuar dokumentacionit të administruar në dosjen e ILDKPKI-së, ASHK-ja Lushnjë¹⁰ konfirmon se subjekti i rivlerësimit ka në bashkëpronësi pasurinë nr. *** e llojit ‘Arë’, me sip. 5.420 m², në fshatin G.

31. Komisioni vëren se bashkëlidhur këtij dokumentacioni gjendet kontrata e pjesëtimit të pasurisë nr. ***, datë 18.10.2017, midis bashkëpronarëve F., D. dhe Flojera Davidhi (veprime këto të kryera pas dorëzimit të deklaratës *Vetting*). Sipas dokumentacionit rezulton se në emër të tyre figurojnë të regjistruara pasuritë e paluajtshme të ndodhura në z. k. ***, fshati G., si vijon: (1) pasuria e llojit “arë”, me sip. 6.081 m², me nr. ***, vol. ***, f. ***; (2) pasuria e llojit “arë”, me sip. 1.084 m², me nr. ***, vol. ***, f. ***; (3) pasuria e

⁸AMTP-ja nr. *** akti, datë 4.3.1993, në fshatin G., Lushnjë, në emër të shtetasit M.N.D., të sip. 16.429 m² dhe 170 m² në përdorim. Certifikatë familjare, datë 24.10.2016.

⁹Shkresë nr. *** prot., datë 8.5.2020.

¹⁰Shkresat nr. *** prot., datë 4.10.2017, dhe datë 6.4.2018, e ZQRPP-së Tiranë dhe posta elektronike, datë 17.4.2019, e ZVRPP-së Lushnjë.

llojit “arë”, me sip. 6.632 m², me nr. ***, vol. ***, f. ***; (4) pasuria e llojit “arë”, me sip. 198 m², me nr. ***, vol. ***, f. ***; (5) pasuria e llojit “arë”, me sip. 1960 m², nr. ***, vol. ***, f. ***.

32. Bashkëpronarët kanë bërë pjesëtimin e pasurive të paluajtshme, të përfituara me dëshmi trashëgimie, nga ku rezulton se subjekti i rivlerësimit ka marrë në pronësi pasurinë e llojit “arë”, me sip. 6081 m², me nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, e ndodhur në fshatin G., Divjakë, regjistruar në ZVRPP-në Lushnjë, ndërkohë që pasuritë e tjera janë ndarë ndërmjet nënës dhe vëllait të subjektit.

33. Në DPV-në e vitit 2017, subjekti ka deklaruar: “Pasuria nr. ***, e llojit ‘arë’, me sip. 6081 m², vol. ***, f. ***, z. k. ***, e ndodhur në fshatin G., regjistruar në ZVRPP-në Lushnjë (Kemi regjistruar pronat që kisha në bashkëpronësi me nënën dhe vëllain, fituar me AMTP dhe trashëgim nga babai. Pas regjistrimit kemi bërë pjesëtim pasurie dhe tashmë jam pronare e vetme e kësaj prone). Pajisur me certifikatë për vërtetim pronësie, datë 25.10.2017. Pjesa takuese: 100 %”.

34. Në përfundim, trupi gjykues konkludon se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin këtë pasuri, si dhe burimi i krijimit/fitimi i pronësisë rrjedh nga ligji.

2. Tokë bujqësore me sip. 4.000 m², në fshatin G., Lushnjë

35. Në deklaratën *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Tokë bujqësore fituar me trashëgimi nga gjyshi N.D., i cili e ka fituar sipërfaqen prej afërsisht 4.000 m² me ligjin nr. 7501, ‘Për tokën’ (pa regjistruar në regjistrat publikë). Pjesa takuese: 1/24”. Si burim krijimi subjekti ka deklaruar ligjin nr. 7501, “Për tokën”. Për vërtetimin e deklarimeve, subjekti ka paraqitur dokumentacion ligjor provues¹¹.

36. Faktet nga hetimi administrativ kryesisht – në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës të vitit 2013, subjekti ka deklaruar tokë bujqësore me sip. 4.000 m², e trashëguar nga gjyshi, ndodhur në fshatin G., komuna G., Lushnjë, pjesa 1/24 (e paregjistruar në regjistrat publik). Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka dorëzuar AMTP-në nr. *** akti, datë 4.3.1993, të sip. 16.430 m², dhe sip. 170 m², në përdorim, ndodhur në fshatin G., Lushnjë, lëshuar në emër të shtetasit F.N.D., si dhe vendimi nr. ***, datë 2.7.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, për çeljen e trashëgimisë pas vdekjes së shtetasit N.D., duke përcaktuar si trashëgimtare bashkëshorten dhe 7 fëmijët me 1/8 pjesë. Në procesverbalin e mbajtur pranë ILDKPKI-së në datën 17.9.2014, subjekti është pyetur lidhur me deklaratimet në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës dhe shpjegon se familja bujqësore në atë kohë përbëhej nga 4 anëtarë (xhaxhai, halla, gjyshi dhe gjyshja), ku sipërfaqja prej 4.000 m² tokë bujqësore i kanë takuar gjyshit të subjektit N.D. dhe familja e saj ka trashëguar pjesën takuese. Subjekti ka sqaruar se kjo tokë përdoret nga xhaxhai saj. Në momentin e regjistrimit do të deklarohet saktë sipërfaqja takuese.

¹¹AMTP-ja nr. *** akti, datë 4.3.1993, e sip. 16.430 m², dhe sip. 170 m², në përdorim, në fshatin G., Lushnjë, në emër të shtetasit F.N.D. Certifikatë familjare, datë 24.10.2016; vendim nr. ***, datë 2.7.2012, për çeljen e trashëgimisë pas vdekjes së shtetasit N.D., duke përcaktuar si trashëgimtare bashkëshorten dhe 7 fëmijët me 1/8 pjesë.

37. Komisioni vëren se sipas certifikatës familjare, datë 30.4.2012, rezulton se në përbërjen familjare të trashëgimtarit N.D. janë bashkëshortja dhe dy fëmijët e tij (F. dhe M.D.). Pjesa e trashëgimlënësit ($16.430 \text{ m}^2 : 4 = 4.107 \text{ m}^2$).

38. Referuar dokumentacionit të administruar në dosjen e ILDKPKI-së, ASHK-ja Lushnjë¹² konfirmon se babai i subjektit të rivlerësimit ka qenë bashkëpronar i pasurisë së paluajtshme të llojit “arë”, me sip. 5.420 m^2 , me nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***. Sipas certifikatës së pronësisë, datë 15.10.2012 (nr. serial ***), bashkëpronarët e mësipërm kanë pasur të regjistruar edhe pasurinë e llojit “arë”, me sip. 2.000 m^2 , me nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***. Më tej, me kontratën nr. ***, datë 20.10.2012, me palë shitëse K.D., U.K., T.D., K.D., Sh.K., M.K., D.D., F.D., F.D., F.D., dhe palë blerëse F.Z., bashkëpronarët e kanë shitur pasurinë e llojit “arë”, me sip. 2.000 m^2 , me nr. ***, në vlerën 1.520.000 lekë.

39. Në përfundim, trupi gjykues konkludon se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin këtë pasuri, si dhe burimi i krijimit/fitimi i pronësisë është në përputhje me ligjin.

3. Kartë krediti me vlerë limit 500 euro, në “Union Bank”

40. Në deklaratën *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Kartë krediti me vlerë limit 500 euro, dhënë nga ‘Union Bank’. Mbetur pa përdorur: 115,47 euro. Pjesa takuese: 100 %. Për vërtetimin e deklarimeve, subjekti ka paraqitur dokumentacion ligjor provues¹³.”

41. Faktet nga hetimi administrativ kryesisht – referuar dokumentacionit të administruar nga “Union Bank”¹⁴ rezulton se subjekti Flojera Davidhi ka llogari rrjedhëse për kartë krediti në euro, me status “aktiv”, hapur në datën 23.3.2016, me detyrim 346,28 euro në datën 28.1.2017.

42. Në përfundim, trupi gjykues konkludon se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin këtë detyrim dhe ka burime financiare të ligjshme për shlyerjen e kartës së kreditit.

4. Shtëpi banimi, me sip. 97 m^2 , në fshatin G., Divjakë

43. Në deklaratën *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Shtëpi banimi, me sip. 97 m^2 , ndodhur në fshatin G., Bashkia Divjakë, pasuria nr. ***, ndërtuar para vitit 1990 (e paregjistruar në regjistrat publikë). Pjesa takuese: 1/6”. Si burim krijimi subjekti ka deklaruar: *përfutur pjesa nga babai me trashëgimi*. Për vërtetimin e deklarimeve, subjekti ka paraqitur dokumentacion ligjor provues¹⁵.

44. Faktet nga hetimi administrativ kryesisht – Në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës të vitit 2013, subjekti ka deklaruar *shtëpi private me sip. 120 m^2 , ndodhur në G., pjesa takuese: 1/3 (e paregjistruar në regjistrat publikë)*. Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka paraqitur vërtetimin, datë 26.10.2016, të Bashkisë Divjakë, Zyra e

¹²Dosja e ILDKPKI-së: shkresat nr. *** prot., datë 4.10.2017, dhe datë 6.4.2018, të ZQRPP-së Tiranë dhe posta elektronike, datë 17.4.2019, e ZVRPP-së Lushnjë.

¹³Kontratë kredi konsumatore kartë krediti – *Master Card*, datë 18.3.2016, në emër të znj. Flojera Davidhi. Aneks nr.*** të kartës së kreditit me limit 500 euro, me afat 2-vjeçar.

¹⁴Shkresa nr. *** prot., datë 25.2.2020.

¹⁵Vërtetim datë 26.10.2016, lëshuar nga Bashkia Divjakë, Zyra e Kadastrës, vendimi nr. ***, datë 25.6.2012, për çeljen e trashëgimisë pas vdekjes së shtetasit M.D.

Kadastrës, ku konfirmohet se pasuria e llojit “arë + truall”, me nr. ***, vol. ***, f. ***, indeksi ***, me sip. 423 m², nga e cila 200 m² truall dhe 97 m² ndërtesë, ndodhur në z. k. ***, G., është e regjistruar në bashkëpronësi të shtetasit M.D. Në procesverbalin e mbajtur pranë ILDKPKI-së në datën 17.9.2014, lidhur më këtë banesë, subjekti shpjegon se familja e saj e ka ndërtuar në vitin 1986 dhe nuk është e regjistruar në regjistrat publikë. Për të provuar deklaratimet e saj ka paraqitur vërtetimin e datës 15.9.2014, lëshuar nga komuna G., Lushnjë, sipas të cilit vërtetohet se z. M.D., banor i këtij fshati, ka në pronësi një shtëpi banimi me sip. 97 m². Në momentin e regjistrimit do të deklarohet saktë sipërfaqja takuese.

45. Sipas dokumentacionit të administruar në dosjen e ILDKPKI-së, ASHK-ja Lushnjë¹⁶ konfirmon se në emër të shtetasve D., F. dhe Flojera Davidhi figuron e regjistruara pasuria e paluajtshme e llojit “arë + truall”, me nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, me sipërfaqe totale 474 m², nga kjo sipërfaqe trualli 200 m² dhe sipërfaqe ndërtesë 97 m², ndodhur në fshatin G.¹⁷.

46. Sipas dëshmisë së trashëgimisë nga babai, subjekti ka përfituruar 1/3 pjesë të pasurisë. Më pas, bashkëpronarët kanë bërë pjesëtimin e pasurive të paluajtshme të përfituara nga trashëgimia, nga ku rezulton se kjo pasuri ka kaluar në bashkëpronësi të nënës dhe vëllait të subjektit.

47. Në përfundim, trupi gjykues konkludon se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin këtë pasuri, si dhe burimi i krijimit/fitimi i pronësisë rrjedh nga trashëgimia ligjore. Nuk u konstatuan problematika të cilat lidheshin me subjektin e rivlerësimit.

5. Ndërtesë e llojit “njësi” me sipërfaqe ndërtimi 63 m², ndërtuar në vitin 2001

48. Në deklaratën *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Ndërtesë e llojit ‘njësi’, me sipërfaqe ndërtimi 63 m², ndërtuar në vitin 2001, mbi pronën e fituar me AMT-në nr. ***, e paregjistruar në regjistrat publikë, në proces legalizimi. Pjesa takuese: 1/6”. Si burim krijimi subjekti ka deklaruar: *përfituruar pjesa nga babai me trashëgimi*. Për vërtetimin e deklaratimeve, subjekti ka paraqitur dokumentacion ligjor provues¹⁸.

49. Faktet nga hetimi administrativ kryesisht – në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës të vitit 2013, subjekti ka deklaruar: *lokal me sip. 80 m², ndodhur në G., pjesa takuese: 1/3 (paregjistruar në regjistrat publik)*. Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka paraqitur shkresën nr. *** prot., datë 18.10.2016, nga ku rezulton se nëna e subjektit D.D., në datën 17.11.2006, ka plotësuar formularin e vetëdeklarimit për legalizim objekti “lokal tregtie” në G., data e ndërtimit 16.5.2001, me sip. të zënë 100 m², nga e cila 63 m² është ndërtesë. Në procesverbalin e mbajtur pranë ILDKPKI-së në datën 17.9.2014,

¹⁶Shkresat nr. *** prot., datë 4.10.2017, dhe datë 6.4.2018, të ZQRPP-së Tiranë dhe posta elektronike datë 17.4.2019, e ZVRPP-së Lushnjë.

¹⁷Certifikatë pronësie datë 16.10.2017 (nr. reference ***).

¹⁸Kthim përgjigje nr. *** prot., datë 18.10.2016, nga Drejtoria e ALUIZNI-t Lushnjë, drejtuar shtetas D.D., bashkëlidhur dokumentacion përkatës: vetëdeklarim për legalizim objekti datë 17.11.2006, lokal tregtie në G., me vit ndërtimi 16.5.2001, me deklaruere shtetasen D.D.; procesverbal nr. ***; foto të objektit; planimetria e katit përdhe me sip. ndërtimi 83,24 m², sip. social-ekonomike 64,34 m², sip. verande 13,5 m² dh shkalle me sip. 5,4 m²; genplan; procesverbal i verifikimit në teren; deklaratë për zbatimin e planit rregullues datë 17.8.2010, deklaratë personale datë 17.8.2010, në emër të shtetas D.D.

lidhur me këtë pasuri, subjekti shpjegon se prindërit e saj e kanë ndërtuar në vitin 2001, ndodhet ngjitur me shtëpinë e banimit të përmendur më sipër dhe është në proces legalizimi. Për të provuar deklaratimet, subjekti ka paraqitur shkresën nr. *** prot., datë 9.9.2014, të ALUIZNI-t Fier, nga ku rezulton se znj. D.D. në datën 17.11.2006 ka dorëzuar formularin e vetëdeklarimit për legalizimin e këtij objekti. Ky lokal është dhënë me qira dhe punohet nga të tretë pa kontratë qiraje.

50. Sipas dokumentacionit të administruar nga ASHK-ja¹⁹, znj. D.D. (mamaja e subjektit) rezulton aplikuese me vetëdeklarim në procesin e legalizimit. Gjithashtu, referuar dokumentacionit të administruar në dosjen e ILDKPKI-së, ASHK-ja Lushnjë²⁰ konfirmohet se znj. D.D. ka aplikuar për legalizimin e objektit informal me sipërfaqe ndërtimi 83,24 m² (sipërfaqe sociale-ekonomike 64,34 m², sipërfaqe verande 13,5 m² dhe shkallë me sip. 5,4 m²) – bashkëlidhur shkresa nr. *** prot., datë 21.3.2019, lëshuar nga ALUIZNI Lushnjë, ku rezulton se janë plotësuar kriteret për të vazhduar me procedurën e legalizimit të objektit.

51. Në përfundim, trupi gjykues konkludon se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin këtë pasuri, si dhe burimi i krijimit/fitimi i pronësisë rrjedh nga trashëgimia ligjore. Nuk u konstatuan problematika të cilat lidhen me deklaratimin apo burimin e ligjshëm të kësaj pasuri, për të cilat kryhet rivlerësimi i subjektit.

6. Apartament me qira në Korçë, me vlerë 18.000 lekë/muaj

52. Në deklaratën *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Në përdorim kam një apartament të marrë me qira ku jetoj së bashku me bashkëshortin tim, në qytetin e Korçës, kontratë e datës 10.10.2015. Sipërfaqja: 83,87 m². Pjesa takuese: 0 %”. Për vërtetimin e deklaratimeve, subjekti ka paraqitur dokumentacion ligjor provues²¹.

53. Faktet nga hetimi administrativ kryesisht – në DPV-të e viteve 2015 dhe 2016, subjekti ka deklaruar si adresë banimi: rruga “***”, kulla ***, kati i ***, Korçë, por nuk janë deklaruar shpenzime qiraje.²² Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka dorëzuar një kontratë të thjeshtë qiraje (jo e lidhur para noterit publik), të datës 10.10.2015, me palë qiradhënëse L.Sh. dhe palë qiramarrëse K.B., për apartamentin me nr. pas. ***, me sip. 83,87 m², në rrugën “***”, Korçë, pa afat, në vlerën 18.000 lekë/muaj. Sipas certifikatës së pronësisë nr. ***, datë 2.6.2004, ky apartament është i regjistruar në emër të qiradhënësit L.Sh. Gjithashtu, referuar dokumentacionit të administruar në dosjen e ILDKPKI-së, ASHK-ja Korçë²³ konfirmon se pasuria e llojit “apartament”, me nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, figuron e regjistruar në emër të shtetasit L.Sh.

54. Në pyetësorin standard, subjekti ka paraqitur deklaratën noteriale nr. ***, datë 22.1.2020, lëshuar nga z. L.Sh., i cili deklaroi se ka në pronësi apartamentin e ndodhur

¹⁹Shkresë nr. *** prot., datë 22.1.2020.

²⁰ Shkresat nr. *** prot., datë 4.10.2017, dhe datë 6.4.2018, të ZQRPP-së Tiranë dhe posta elektronike, datë 17.4.2019, e ZVRPP-së Lushnjë.

²¹Kontratë qiraje, datë 10.10.2015, me palë qiradhënëse L.Sh., dhe palë qiramarrëse K.B., të apartamentit me nr. pasurisë ***, me sip. 83,87 m², kati i ***, në rrugën “***”, Korçë, pa afat, në vlerën 18.000 lekë/muaj. Bashkëlidhur certifikatë e pronësisë në emër të shtetasit L.Sh.

²²Në DPV-në e vitit 2017 e në vijim, subjekti deklaroi si adresë banimi: Lagjja nr. ***, blv. “***”, shtëpi private, kati i ***, Korçë.

²³E-mail, datë 17.4.2019.

në Lagjen nr. ***, rr. “****”, p. ***, k. i ***, Korçë. Për periudhën 10.10.2015 – 14.3.2017 në këtë banesë kanë banuar me qira subjekti dhe bashkëshorti Z.B., kundrejt qirasë 18.000 lekë/muaj, pagesë e cila bëhej *cash*.

55. Në pyetësin nr. 1, subjekti u pyet lidhur me adresën: Lagjja nr. ***, rruga “****”, pallati nr. ***, Korçë, e cila rezultoi në kontratën bankare të lidhur nga subjekti me “Union Bank”. Në përgjigje, subjekti deklaroi se nuk e di ku ndodhet dhe nuk ka jetuar ndonjëherë në këtë adresë dhe se mund të jetë ndonjë gabim material nga ana e saj ose e punonjësës së bankës, ndaj të cilit në atë kohë nuk i ka kushtuar kurrfarë rëndësie.

56. Nga hetimi pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë²⁴ nuk u provua qenia e subjektit të rivlerësimit në kushtet e konfliktit të interesit²⁵ me qiradhënësin e këtij apartamenti.

57. Në përfundim, trupi gjykues konkludon se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin marrëdhënien e qirasë, ka burime të ligjshme për pagimin e detyrimit që rrjedh nga qiraja, nuk rezultoi që subjekti të ishte në kushtet e konfliktit të interesit me qiradhënësin dhe nuk ka *indicie* për pasuri të fshehur të subjektit apo bashkëshortit të saj.

Lidhur me vendbanimet e tjera të subjektit të rivlerësimit gjatë ushtrimit të detyrës

58. Në DPV-në e vitit 2013, në seksionin “nëse dispononi vend tjetër qëndrimi”, subjekti ka deklaruar adresën: rruga “****”, Tiranë. Në procesverbalin e mbajtur pranë ILDKPKI-së në datën 17.9.2014, subjekti është pyetur se ku banon, ku në përgjigje sqaron se ka banuar në adresën e mësipërme në bazë të një kontrate qiraje e cila ka përfunduar në korrik të vitit 2014 dhe detyrimi mujor i qirasë ka qenë 25.000 lekë. E pyetur se përse nuk ka deklaruar shpenzime qiraje, subjekti shpjegoi se qiraja e banesës është paguar paradhënie dy muaj, në datën 1.11.2013, në momentin e lidhjes së kontratës dhe hyrjes në banesë, të cilat nuk i ka deklaruar pasi për periudhën 21.11.2013 – 31.12.2013 nuk ka paguar qira banese.

59. Në DPV-në e vitit 2014, subjekti deklaroi se nuk e disponon më banesën që ka pasur me qira në rrugën “****”, Tiranë. Në seksionin “detyrime financiare”, subjekti ka deklaruar pagesë qiraje në vlerën 175.000 lekë, për banimin në apartamentin e mësipërm, me kontratë verbale.

60. Në pyetësin standard, subjekti ka deklaruar se në periudhën gusht 2014 – tetor 2015 ka jetuar në banesën e familjes në fshatin G. Në periudhën mars 2017 – tetor 2019 ka jetuar në banesën me qira në adresën: Lagjja nr. ***, blv. ***, godina ***, Korçë. Në periudhën 21 tetor 2019 – 30 nëntor 2019 ka jetuar në Tiranë, në adresën: rr. “****”, ndërtesa ***, h. ***, ap. ***, Njësia Bashkiake nr. ***, Laprakë, në banesën e prindërve të bashkëshortit Z. dhe H.B. Në periudhën 1 dhjetor 2019 – e në vijim jeton me qira në adresën: rr. “****”, p. ***, k. i ***, ap. ***, Tiranë (ish-****) në një apartament 1+1.

61. Referuar dokumentacionit të administruar nga ASHK-ja Lushnjë²⁶, në emër të shtetasit Z.B. figuron e regjistruar pasuria e llojit “apartament”, me sip. 55 m², z.k. ***, vol. ***, f. ***. Babai i bashkëshortit të subjektit Z.B., me kontratën nr. ***, datë

²⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 21.4.2021.

²⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 23.4.2021, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

²⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 4.2.2020.

30.5.2006, ka blerë apartamentin me sip. 55m², me adresë: rr. “****”, p. ***, shk. ***, k. i ***, ap. ***, Tiranë, në vlerën 2.000.000 lekë.

62. Subjekti, në pyetësin standard, ka dorëzuar certifikatën e pronësisë nr. ***, datë 31.5.2006, lëshuar në emër të shtetasit Z.B. për pasurinë apartament me nr. ***, vol. ***, f. ***, në Tiranë. Më tej, sipas dokumentacionit të administruar nga ASHK-ja, rezultojnë se në emër të shtetasit Z.B. rezultojnë edhe apartamenti me adresë: rr. “****”, godina nr. ***, h. ***, ap. ***, Berat. Sipas kartelës së pasurisë, ky apartament është blerë në shumën 2.000.000 lekë, data e lëshimit të certifikatës 2.6.2006 dhe data e regjistrimit 22.10.2014.

63. Si përfundim, Komisioni vlerëson se të dyja këto pasuri janë blerë para se subjekti të lidhte martesë ligjore me bashkëshortin K.B., nuk u konstatua ndonjë *indicie* apo provë që të vërtetonte kontributin e subjektit gjatë ushtrimit të detyrës. Për rrjedhojë, pavarësisht hetimit mbi këto pasuri, Komisioni vlerëson se nuk ndikojnë në procesin e rivlerësimit të subjektit.

PASURITË E BASHKËSHORTIT TË SUBJEKTIT

7. Automjet tip “Opel Corsa”, me targa *, vlera 3.000 euro**

64. Në deklaratën *Vetting*, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka deklaruar: “*Automjet tip ‘Opel Corsa C’, me nr. shasie ***, naftë, viti i prodhimit 2006, me targa ***, blerë në datën 10.9.2013 nga shtetasi E.Zh., në bazë të kontratës nr. ***, datë 10.9.2013, Tiranë. Vlera 3.000 euro. Pjesa takuese: 100%*”. Si burim krijimi ka deklaruar të ardhurat familjare dhe për vërtetimin e deklarimeve ka paraqitur dokumentacion ligjor provues²⁷.

65. Faktet nga hetimi administrativ kryesisht – në DPV-në e vitit 2015 bashkëshorti i subjektit ka deklaruar: “*Automjet tip ‘Opel Corsa’, viti i prodhimit 2006, me targa ***, blerë me kontratën, datë 10.9.2013, në vlerën 3.000 euro. Pjesa takuese: 100%*”. Në DPV-në e vitit 2017 bashkëshorti i subjektit ka deklaruar: *të ardhura në vlerën 300.000 lekë nga shitja e automjetit tip “Opel Corsa”, me kontratën e datës nr. ***, datë 10.10.2017. Pjesa takuese: 100 %*”.

66. Sipas dokumentacionit të administruar nga DRSHTRR-ja²⁸, rezultojnë se në emër të shtetasit K.B. janë të regjistruara automjetet tip “Opel Corsa”, viti i prodhimit 2006, me targa ***, blerë me kontratën e shitjes nr. ***, datë 10.9.2013, në vlerën 3.000 euro dhe automjeti me targa ***²⁹.

67. Në pyetësin standard, subjekti ka paraqitur kontratën e shitjes së automjetit me nr. ***, datë 10.10.2017, të blerësi shtetasi E.R., në vlerën 300.000 lekë.

68. Nga kontrolli në AMF rezultojnë se policat e sigurimit janë prerë në emër të bashkëshortit të subjektit nga viti 2013 deri në vitin 2020. Sa më sipër, rezultojnë se ky automjet është shitur në datën 10.10.2017 dhe blerësi shtetasi E.R. figuron në cilësinë e përdoruesit deri në vitin 2020 (polica datë 10.4.2019 – 3.10.2020).

²⁷ Kontratë shitjeje automjeti nr. ***, datë 10.9.2013, me palë shitëse E.Zh. dhe palë blerëse K.B., të automjetit tip “Opel Corsa”, në vlerën 3000 euro.

²⁸ Shkresë nr. ***, datë 22.1.2020.

²⁹ Automjeti tip “Volkswagen Passat” është blerë me kontratën nr. ***, datë 7.5.2018, në vlerën 5.000 euro, likuiduar jashtë zyrës noteriale. Deklaruar në DPV-në e vitit 2018.

Ndërkohë, në emër të subjektit të rivlerësimit nuk figurojnë të dhëna në AMF. Me anë të pyetësorit nr. 2, Komisioni i kërkoi subjektit të paraqesë dokumentacion ligjor justifikues lidhur me të ardhurat që kanë shërbyer për blerjen e këtij automjeti. Në përgjigje, subjekti ka deklaruar se: “Të ardhurat për blerjen e këtij automjeti, sipas thënieve të bashkëshortit, janë konkretisht të ardhurat nga paga të babait të bashkëshortit, të ardhurat nga paga e bashkëshortit, të ardhurat nga pensioni i nënës së bashkëshortit, si dhe të ardhurat e dërguara nga vëllai R.B., që jeton në Britaninë e Madhe, për të ndihmuar familjen”. Subjekti ka dorëzuar dokumentacion ligjor justifikues³⁰, nga ku provohet se për periudhën 6.4.2011 – 6.4.2013, vetëm të ardhurat (përpara taksave) nga vetëpunësimi i vëllait, kanë qenë në shumën 21.295 GBP.

69. Për sa më sipër, konstatohet se ky automjet është blerë me të ardhurat familjare të familjes së bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit përpara martesës së tyre ligjore (16.10.2015³¹) dhe përpara emërimit në detyrë të subjektit (21.10.2013).

70. Si konkluzion në lidhje me këtë pasuri, Komisioni vlerëson se nuk ka *indicie* të cilat mund të ngrenë dyshime për pasuri të fshehur/a të subjektit të rivlerësimit dhe nuk ndikojnë në procesin e rivlerësimit.

71. Më tej, subjektit iu kërkuan shpjegime në lidhje me konstatimin se automjeti tip “Opel Corsa”, me targa ***, është shitur me kontratën nr. ***, në datën 10.10.2017, ndërkohë që nga kontrolli në AMF rezulton se policat e sigurimit janë prerë në emër të personit të lidhur K.B., deri në vitin 2020 dhe blerësi i këtij automjeti E.R. figuron në cilësinë e përdoruesit deri në datën 3.10.2020. Subjekti, në shpjegimet e saj, ka deklaruar se ka ardhur në dijeni të këtij fakti vetëm pas komunikimit të relacionit “Mbi rezultatet e hetimit kryesisht për të tria kriteret e rivlerësimit”. Më tej, nga verifikimi në DPSHTRr konstatoi se blerësi i automjetit E.R. e ka kryer ndryshimin e pronësisë së automjetit vetëm në datën 25.2.2020. Për këtë shkak, duke përfituar edhe nga fakti se shoqëritë e sigurimit apo agjentët e tyre nuk kërkojnë prezencën fizike të pronarit të automjetit, nga sa duket, blerësi ka vijuar të presë policat e sigurimit, përveçse në emër të vet, edhe në emër të bashkëshortit të subjektit, ku ky i fundit nuk ka pasur dijeni për këtë veprim të blerësit.

72. Analiza e Komisionit – trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit shpjegoi bindshëm se automjeti objekt hetimi është tjetërsuar me kontratën nr. ***, datë 10.10.2017. Nga momenti i shitjes, shitësi/bashkëshorti i subjektit nuk ka detyrimin ligjor për të depozituar kontratën e shitjes në DPSHTRr, pasi sipas nenit 93 të Kodit Rrugor kjo përgjegjësi është e blerësit të automjetit.

73. Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit shpjegoi bindshëm këtë mospërputhje të konstatuar nga Komisioni dhe nuk u konstatuan *indicie* të tjera të cilat ndikojnë procesin e rivlerësimit për subjektin.

³⁰ Listëpagesat e viteve 2012 - 2013 e në vazhdim të babait të bashkëshortit, shtetasit Z.B., ku ka punuar pranë firmave “****” dhe “****”, si teknik ndërtimi; listpagesat e vitit 2013 (që nga muaji prill) e në vazhdim të bashkëshortit K.B., ku ka punuar pranë autoshkollës “****”, si drejtues teknik; vërtetimi i taksave të vëllait R.B., për periudhën 2012 – 2013, vërtetuar dokumentacioni sipas vërtetimit dhe verifikimit të dokumenteve të ndryshme të noteres publike A.Gj.; vërtetimi nr. *** prot., datë 27.4.2021, nga DRSSH-ja Tiranë në lidhje me të ardhurat nga pensioni i nënës së bashkëshortit H.B., për periudhën 30.1.2013 – 31.12.2013.

³¹ Referoju certifikatës së martesës së dorëzuar nga subjekti në deklaratën *Vetting*.

8. Llogari page në vlerën 85.693 lekë, në “Credins Bank”

74. Në deklaratën *Vetting*, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka deklaruar: “*Llogari page nga puna si specialist pranë drejtorisë së ALUIZNI-t Korçë (filluar punë në nëntor të vitit 2015, për shkak të emërimit përfundimtar të bashkëshortes në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë e në vazhdim). Vlera: 85.693 lekë. Pjesa takuese: 100 %*”. Si burim krijimi ka deklaruar të ardhurat nga paga dhe për vërtetimin e deklarimeve ka paraqitur dokumentacion ligjor provues³².

75. Faktet nga hetimi administrativ kryesisht – sipas dokumentacioni të administruar nga “Credins Bank”³³, bashkëshorti i subjektit K.B. zotëron llogari bankare pranë kësaj banke, me gjendje 85.693 lekë në datën 26.1.2017. Konstatohet se kjo llogari është çelur në datën 1.1.2013 dhe kreditimet në llogari kanë si burim pagat.

76. Në përfundim të hetimit të kësaj llogarie, Komisioni vlerëson se personi i lidhur me subjektin/bashkëshorti ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin këtë llogari dhe identifikohen qartë transfertat nga paga e personit të lidhur, pra, verifikohet burimi i ligjshëm i kësaj llogarie.

9. Mbajtës i depozitës bankare të znj. E.B./motra e bashkëshortit të subjektit, në vlerën 4.000.000 lekë

77. Në deklaratën *Vetting*, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka deklaruar: “*Mbajtës i depozitës bankare të hapur në datën 1.11.2013, me afat trevjeçar, mbaruar më 1.11.2016, dhe rinovuar më 7.11.2016, me afat 30-mujor. Fillimisht kjo depozitë është hapur si llogari kursimi në GBP në datën 9.2.20106. Të ardhura të motrës (E.B.) nga emigracioni në Angli (L.), si emigrante e paligjshme ku jeton dhe sot dhe depozita është e saj. M’i ka dërguar paratë me anë të personave të tjerë të familjes, duke i depozituar në Shqipëri, meqenëse është e paligjshme në Angli. Vlera: 4.000.000 lekë. Pjesa takuese: 0 %*”. Si burim krijimi ka deklaruar të ardhura të motrës (E.B.) nga emigracioni në Angli (L.), si emigrante e paligjshme ku jeton edhe sot dhe për vërtetimin e deklarimeve, subjekti ka paraqitur dokumentacion ligjor provues³⁴.

78. Faktet nga hetimi administrativ kryesisht – në DPV-në e vitit 2015, bashkëshorti i subjektit (deklaron si person i lidhur për herë të parë) ka deklaruar *depozitë në “Intesa Sanpaolo Bank”, hapur në datën 9.2.2006, krijuar me të ardhura nga emigracioni nga motra në Angli. Vlera: 4.000.000 lekë*. Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka dorëzuar vërtetimin, datë 24.1.2017, të lëshuar nga “Intesa Sanpaolo Bank”, ku vërtetohet se bashkëshorti i subjektit K.B. ka një depozitë bankare në vlerën 4.000.000 lekë, hapur në datën 1.11.2013, me afat maturimi trevjeçar deri në datën 1.11.2016, rinovuar më 7.11.2016, me afat 30-mujor. Interesat e përfituara vitin e parë janë në shumën 100.885

³² Nxjerrje llogarie bankare në datën 24.1.2017, në “Credins Bank”, në emër të shtetasit K.B., në të cilën kreditohet paga për periudhën 25.1.2016 – 29.12.2016. Balanca në datën 24.1.2017, është 85.693 lekë; vërtetim nr. *** prot., datë 24.1.2017, nga “Credins Bank”, vërteton se shtetasi K.B. ka llogari page me gjendje 85.693 lekë

³³ Shkresë nr. *** prot., datë 28.1.2020.

³⁴ Vërtetim, datë 24.1.2017, nga “Intesa Sanpaolo Bank”, e cila vërteton se shtetasi K.B. ka depozitë bankare në vlerën 4.000.000 lekë. Interesat e përfituara vitin e parë janë në shumën 100.885 lekë, viti i dytë në shumën 137.257 lekë dhe në vitin e tretë shuma e interesave të depozitës është 194.588 lekë.

lekë, vitin e dytë në shumën 137.257,61 lekë dhe vitin e tretë në shumën 194.588,57 lekë.

79. Sipas dokumentacionit të administruar nga “Intesa Sanpaolo Bank”³⁵, konfirmohet se në datën 28.1.2017 bashkëshorti i subjektit/K.B. ka pasur depozitë bankare në vlerën 4.000.000 lekë. DPPP-jë, me shkresën nr. *** prot., datë 21.1.2020, konfirmon se për bashkëshortin e subjektin K.B. rezultojnë këto raportime të transaksioneve bankare në emër të tij: (i) në datën 27.9.2011 – 20.700 GBP, K.B., shlyerje borxhi; (ii) në datën 3.9.2012 – 9.900 GBP, kreditim/ kursime nga emigracioni K.Z.B.; (iii) në datën 24.10.2012 – 25.000 GBP, këmbim për T.D. K.B.; (iv) në datën 24.10.2012 – 4.307.500 lekë, këmbim për T.D. K.B. trans.

80. Në pyetësonin standard, subjekti ka deklaruar se personi i lidhur K.B. ka pasur deri në gusht të vitit 2019 një depozitë bankare dhe një llogari rrjedhëse në “Intesa Sanpaolo Bank”, ku asnjëra prej tyre nuk ishte në pronësi të tij, në kuptim të të ardhurave/valutës që ndodhej në to. Lidhur me depozitën bankare, subjekti ka deklaruar se është hapur në datën 1.11.2013, me afat trevjeçar deri më 1.11.2016, dhe është rinovuar më 7.11.2016, me afat 30-mujor. Fillimisht kjo depozitë është hapur si llogari kursimi në GBP në datën 9.2.2006 – të ardhura të motrës së bashkëshortit/E.B. nga emigracioni në Angli (L.) si emigrante e paligjshme. Kjo depozitë ka pasur të njëjtën vlerë deri në gusht të vitit 2019, prej 4.000.000 lekësh, siç është deklaruar në deklaratën *Vetting*. Personi i lidhur ka qenë vetëm mbajtës i kësaj llogarie, pra, pjesa e tij në përqindje ka qenë gjithmonë 0 %. Të ardhurat janë dërguar nga motra e tij nëpërmjet personave të tjerë/familjarë, për faktin se ka qenë emigrante e paligjshme dhe ka pasur frikë për ndonjë dëbim. Subjekti ka deklaruar se këto të ardhura janë depozituar përpara se të lidhte martesë ligjore me bashkëshortin. Vetëm në shkurt të vitit 2019 kunata e subjektit ka fituar të drejtën për leje qëndrimi të përkohshëm në Mbretërinë e Bashkuar, pasi djali i saj E.R. ka fituar shtetësinë britanike me vendim gjykate. Mbas ardhjes së saj në Shqipëri pas rreth 13 viteve, në gusht të vitit 2019, personi i lidhur i ka rikthyer shtetësinë E.B. shumën e parave të depozituara.

81. Me anë të pyetësorit nr. 1³⁶, subjektin iu kërkua të paraqesë dokumentacion ligjor justifikues për transfertat e kryera nga znj. E.B. Në përgjigje³⁷, subjekti ka shpjeguar sa vijon: “E.B. ka përfituar një kontratë pune si infermiere në Mbretërinë e Bashkuar, për rrjedhojë, ajo u pajis me leje të rregullt për punë ‘W.P.’, sipas të cilit kishte të drejtë të qëndronte dhe punonte në këtë shtet, për një periudhë kohe 48 muaj”. Në cilësinë e provës subjekti ka dorëzuar “W.P.” të lëshuar nga shteti britanik. Për shkaqe personale, kunata e subjektit e shkeli lejen e qëndrimit dhe kështu mbeti emigrante e paligjshme në këtë shtet. Gjatë kësaj periudhe ka lindur dy fëmijë, të vitlindjeve 2008 dhe 2010. Për shkak të pasigurisë që e shoqëronte, për faktin se ishte emigrante e paligjshme, ajo vendosi që një pjesë të të ardhurave të saj t’i dërgonte në Shqipëri, për t’u ruajtur në një llogari bankare në emër të vëllait të saj K.B., në rast se deportohej nga shteti britanik. Dërgesat i ka kryer nëpërmjet bankës, por edhe nëpërmjet familjarëve të tjerë, të cilat janë dërguar dorazi dhe bashkëshorti i subjektit i ka depozituar *cash* në bankë. Me mbushjen e moshës 10 vjeç, djali i saj, i vitlindjes 2008, u pajis me pasaportë britanike,

³⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 20.1.2020.

³⁶ E-mail datë 23.3.2020, ora 14:42.

³⁷ E-mail datë 31.3.2020, ora 20:24.

duke u njohur kështu si shtetas i ligjshëm britanik. Në vijim, edhe shtetasja E.B. u lejua nga shteti britanik në shkurt të vitit 2019 të qëndronte si e ligjshme në këtë vend, si kujdestare ligjore e fëmijëve të saj. Në korrik të vitit 2019 erdhi në Shqipëri së bashku me dy fëmijët e saj, pas 13 vjetësh. Subjekti dorëzoi, në cilësinë e provës, dokumentin e lejes së qëndrimit, si dhe kopje të pasaportave të kumatës dhe të fëmijëve të saj. Me ardhjen e saj në Shqipëri, bashkëshorti i subjektit ia ka kthyer paratë në datën 5.8.2019. Subjekti dorëzoi, në cilësinë e provës, lëvizjet e llogarisë bankare në “Intesa Sanpaolo Bank” lëvizjet e llogarive bankare të kumatës.

82. Subjekti në përfundim ka deklaruar se këto para nuk kanë qenë ndonjëherë të bashkëshortit, prandaj ai nuk ka investuar në to, por thjesht i ka ruajtur në bankë si depozitë me interesa. Kjo gjë është deklaruar rregullisht (në cilësinë e mbajtësit), por bashkëshorti nuk ka pasur asnjëherë pjesë takuese në këto shuma.

83. Komisioni hetoi mbi origjinën e shumës 4.000.000 lekë dhe nga dokumentacioni i administruar³⁸ vërehet se burim i saj është konvertimi i shumës 22.982,78 GBP në 4.307.500 lekë, në datën 24.10.2012.

84. Për sa i përket shumës 22.982,78 GBP, në llogarinë bankare nr. *** të bashkëshortit të subjektit evidentohet se përgjatë periudhës 1.1.2012³⁹ – 24.10.2012⁴⁰ kanë ndodhur këto veprime: depozitime në vlerën totale +22.100 GBP nga z. K.B.⁴¹; transferta nga znj. E.B. +3.983,92 GBP; interesa +6,04 GBP; kalim +3.000 GBP nga një llogari tjetër e bashkëshortit të subjektit (me burim depozitime të kryera nga vetë ai); tërheqje -4.880 GBP nga K.B.; si dhe konvertim -22.982,78 GBP në lekë.

85. Më tej, për periudhën 2012 – 2016 kanë ndodhur transaksionet në vijim të paraqitura në mënyrë të përmbledhur, ku vërehet se, përveç interesave bankare nuk ka pasur shtesa të tjera në këtë llogari përgjatë kësaj periudhe.

Tabela nr. 1 – Pasqyrë përmbledhëse e lëvizjeve në llogaritë bankare të bashkëshortit në “Intesa Sanpaolo Bank”, për periudhën 2012 – 2016

Përshkrim/Viti	2012	2013	2014	2015	2016
Gjendje në fillim	-	232,605	85	885	258
Transfertë nga llogaria në GBP	4,307,500				
Shlyerje depozite		4,307,500	-		4,000,000
Krijim depozite	-	-	-		- 4,000,000
	4,307,500	4,000,000			
Tërheqje		-	-	-	
		539,970	100,000	137,000	
Komisione		-			
		96,969			
Interesa <i>neto</i>	232,605	96,919	100,800	136,373	194,331
Gjendje në fund llogaria rrjedhëse	232,605	85	885	258	194,589
Gjendje në fund depozita	4,307,500	4,000,000	4,000,000	4,000,000	4,000,000

³⁸ Lëvizjet e llogarive të përcjella nga “Intesa Sanpaolo Bank”, me shkresën nr. *** prot., datë 20.1.2020.

³⁹ Balanca e llogarisë në këtë datë është 0.78 GBP.

⁴⁰ Balanca e llogarisë në datën e konvertimit nga GBP në lekë (24.10.2012) është 1.227,96 GBP, data e konvertimit nga GBP në lekë.

⁴¹ Depozitim datë 30.4.2012, vlerë 3.000 GBP; depozitim datë 21.6.2012, vlerë 10.000 GBP; depozitim datë 2.8.2012, vlerë 200 GBP; depozitim datë 3.9.2012, vlerë 9.900 GBP.

86. Duke qenë se nga hetimi u konstatua se në llogaritë bankare të bashkëshortit të subjektit janë kryer në mënyrë të vazhdueshme tërheqje prej tij, ndërkohë që subjekti ka deklaruar që qëllimi i dërgimit të fondeve në Shqipëri ishte që të ruheshin në llogari bankare. Subjektit, me anë të pyetësorit nr. 2, iu kërkuan shpjegime lidhur me arsyen e këtyre tërheqjeve, ku në përgjigje të saj ka shpjeguar se vërtet qëllimi ka qenë ruajtja e tyre në një llogari bankare në Shqipëri në rast se deportohej nga shteti britanik, por për shkak të nevojave të familjes së saj të origjinës, shtetasja E.B. ka urdhëruar vëllain e saj/K.B. (bashkëshorti i subjektit) që mund të bënte tërheqje nga llogaria e depozitës dhe t'ia dorëzonte familjes.

87. Për sa më sipër, nga hetimi shterues i Komisionit rezulton se shuma 4.000.000 lekë, deklaruar në deklaratën *Vetting*, është krijuar nga transaksionet e kryera në vitin 2012, pra, përpara martesës ligjore (16.10.2015⁴²) dhe përpara emërimit në detyrë të subjektit të rivlerësimit (21.10.2013). Bashkëshorti i subjektit nuk ka deklaruar pjesë takuese të kësaj llogarie në deklaratat periodike vjetore dhe në deklaratën *Vetting*. Gjithashtu, nga hetimi rezultoi e provuar se këto fonde i janë transferuar shtetasës E.B. në datën 5.8.2019.

88. Në konkluzion në lidhje me këtë llogari, Komisioni vlerëson se nuk ka *indicie* të cilat mund të ngrenë dyshime për pasuri të fshehur/a të subjektit të rivlerësimit dhe nuk ndikojnë në procesin e rivlerësimit dhe, për rrjedhojë, Komisioni nuk e përfshiu në analizën financiare këtë depozitë dhe interesat e përfituara prej saj.

10. Gjendje *cash*, në vlerën 200.000 lekë

89. Në deklaratën *Vetting*, bashkëshorti i subjekti të rivlerësimit ka deklaruar: “*Gjendje cash në shtëpi nga puna si instruktor - inxhinier mekanik, me kontratën nr. ***, datë 5.4.2016, pranë Personit Fizik ‘A.Z.’ (autoshkollë). Kemi zgjedhur që në fillim që lekët t’i marrim dorazi. Vlera është 200.000 lekë. Pjesa takuese: 100 %*”. Si burim krijimi ka deklaruar të ardhurat nga puna si instruktor/inxhinier mekanik dhe për vërtetimin e deklarimeve ka paraqitur dokumentacion ligjor provues⁴³.

90. Faktet nga hetimi administrativ kryesisht – në deklaratën *Vetting*, subjekti ka dorëzuar kontratën e punës nr. ***, datë 5.4.2016, me punëdhënësin Person Fizik “A.Z.” dhe punëmarrës K.B., si instruktor teorie në autoshkollë, me pagesë 30.000 lekë/muaj. Kjo kontratë është lidhur pa afat me pagë mujore *neto* 30.000 lekë/muaj. Gjithashtu, subjekti ka paraqitur vërtetimin e datës 27.1.2017, lëshuar nga administratori i subjektit “Autoshkolla Z.”, në të cilën konfirmohet pagesa prej 30.000 lekësh/muaj, për periudhën 1.10.2015 – 27.1.2017, me një pagesë totale *neto* në shumën 450.000 lekë. Në DPV-në e vitit 2016 bashkëshorti i subjektit ka deklaruar gjendje *cash* në banesë në vlerën 200.000 lekë, nga puna si instruktor/inxhinier mekanik, me kontratën nr. ***, datë 5.4.2016, pranë Personit Fizik “A.Z.” (autoshkollë), pagesa do të bëhej dorazi. Fillimisht kanë lidhur kontratën nr. ***, në vitin 2015, të cilën e kanë rinovuar. Pjesa takuese: 100 %.

⁴² Referojuni certifikatës së martesës së dorëzuar nga subjekti në deklaratën *Vetting*.

⁴³ Kontratë pune nr. ***, datë 5.4.2016, punëdhënësi Personi Fizik “A.Z.” dhe punëmarrës K.B., si instruktor teorie në autoshkollë; vërtetim datë 27.1.2017, me punëdhënësin “A.Z.”, i cili ka paguar shtetasin K.B. si instruktor teorie për periudhën 1.10.2015 – 27.1.2017, në vlerën 450.000 lekë.

91. Referuar dokumentacionit të administruar nga ISSh-ja⁴⁴ konstatohet se bashkëshorti i subjektit rezultoi i punësuar pranë subjektit “A.Z.” për periudhën: prill 2016, me pagë *bruto* 15.000 lekë; maj 2016, me pagë *bruto* 30.000 lekë; dhe qershor 2016, me pagë *bruto* 30.000 lekë⁴⁵.

92. Me anë të pyetësorit nr. 1, subjektit iu kërkuan shpjegime lidhur me mospërputhjen midis vërtetimit të lëshuar dhe dokumentacionit të administruar nga ISSh-ja. Në përgjigjen e saj subjekti ka shpjeguar se nga ana e tyre asnjëherë nuk është vënë në dyshim fakti i pagimit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore prej punëdhënësit, ku sipas legjislacionit në fuqi, këto lloj detyrimesh, pra, detyrimi mbi sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, paguhen nga punëdhënësi. Më tej, vijon subjekti, ata nuk kanë pasur dijeni që punëdhënësi nuk i ka shlyer detyrimet e tij.

93. Komisioni përllogariti pagën *neto*, referuar ndalesave të pasqyruara në shkresën e përcjellë nga ISSh-ja, nga ku rezultoi se totali i të ardhurave *neto* për këto tre muaj rezultoi 65.835 lekë, përkundrajt 200.000 lekëve të deklaruar si të kursyera, duke rezultuar në një diferencë prej 134.165 lekësh. Në këto kushte, Komisioni konsideroi si të ardhura të ligjshme vetëm shumën 65.835 lekë, në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, si dhe të pikës 19, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016 dhe i kaloi barrën e provës për sa konstatohet: “*Subjekti dhe personi i lidhur kanë mungesë burimesh të ligjshme prej -134.165 lekësh për krijimin e kursimeve cash në shumën 200.000 lekë*”.

94. Subjekti, në përgjigje të barrës së provës, ka deklaruar se në lidhje me këtë përfundim të arritur nga ana e Komisionit, bashkëshorti i saj K.B. pagesën në lidhje me shërbimin e ofruar në bazë të kontratës së punës nr. ***, datë 5.4.2016, e ka marrë *cash*. Punëdhënësi i ka deklaruar në vijimësi se ka qenë korrekt me shlyerjen e detyrimeve kundrejt shtetit, arsye për të cilën këto të ardhura janë deklaruar rregullisht. Në këto kushte, duke qenë në mirëbesim dhe në pamundësi të verifikimit të përmbushjes së detyrimeve periodike tatimore nga ana e punëdhënësit (sipas legjislacionit tatimor për pagimin e detyrimeve ndaj shtetit ngarkohet punëdhënësi), subjekti ka marrë të mirëqenë këtë fakt dhe nuk ka dyshuar ndonjëherë se ky punëdhënësi nuk ka qenë korrekt me pagimin e detyrimeve ndaj shtetit, ndërkohë që me detyrimet ndaj z. K.B. ka qenë gjithmonë korrekt. Vetëm pas konstatimit të arritur nga Komisioni gjatë procesit të rivlerësimit, subjekti dhe personi i lidhur kanë ardhur në dijeni të faktit që për disa muaj të caktuar nga ana e punëdhënësit nuk janë shlyer detyrimet kundrejt shtetit, në kuadër të marrëdhënies së punës. Këto pagesa të bashkëshortit përbëjnë gjendjen *cash* të deklaruar nga në deklaratën *Vetting*, por subjekti, e vendosur tashmë para një fakti të tillë ku pasojat e krijuara nuk varen dhe nuk janë shkaktuar prej saj dhe bashkëshortit K.B., kërkon nga Komisioni që ky deklaram të vlerësohet në raport me rrethanat e rastit dhe në respektim të parimit të proporcionalitetit dhe objektivitetit.

Arsyetimi ligjor në lidhje faktet dhe ligjin e zbatueshëm

95. Komisioni, pasi shqyrtoi shpjegimet me shkrim të subjektit dhe e dëgjoi në seancë dëgjimore, vlerëson se bazuar në pikën 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, parashikohet se: “[...] *Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të*

⁴⁴ Shkresë nr. ***, datë 15.1.2020.

⁴⁵ Vijon më tej në vitin 2017.

ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore [...], për qëllim të procesit të rivlerësimit të kriterit të pasurisë, si të ardhura të ligjshme duhen konsideruar vetëm të ardhurat të cilat plotësojnë në mënyrë kumulative këto dy kritere, që: (i) janë deklaruar; dhe (ii) për të cilat vërtetohet pagimi i detyrimeve tatimore sipas legjislacionit në fuqi”. Për këtë arsye të ardhurat në shumën 134.165 lekë nuk u konsideruan në analizën financiare.

96. Komisioni çmon se, duke arsyetuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit dhe duke vënë në balancë vlerën e kësaj pamjaftueshmërie në raport me provat e tjera të administruara nga hetimi, kjo mungesë prej 134.165 lekësh nuk mund të kualifikohet në asnjë prej situatave të parashikuara në pikat 1 dhe 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016 dhe të përbëjnë për pasojë një shkak për vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

11. Llogari rrjedhëse nga interesat e depozitës të së motrës E.B., në vlerën 194.588,57 lekë

97. Në deklaratën *Vetting*, bashkëshorti i subjekti të rivlerësimit ka deklaruar: “Llogari rrjedhëse në lekë me gjendje llogarie të ardhurat nga likuidimi i depozitës në datën 1.11.2016, ose ndryshe nga interesat e fituara nga depozita e sipërcituar e motrës sime (E.B.). Vlera: 194.588,57 lekë. Pjesa takuese: 0 %”. Si burim krijimi ka deklaruar likuidimin e depozitës në datën 1.11.2016 ose interesat e fituara nga depozita e motrës E.B. Për vërtetimin e deklarimeve ka paraqitur dokumentacion ligjor provues⁴⁶.

98. Faktet nga hetimi administrativ kryesisht – në DPV-në e vitit 2015, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar të ardhura si interesa vjetore në vlerën 160.000 lekë nga depozita në “Intesa Sanpaolo Bank”, në emër të motrës E.B. (nëntor të vitit 2015). Në DPV-në e vitit 2016, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar llogari rrjedhëse në lekë, me të ardhura në vlerën 194.588,57 lekë nga likuidimi i depozitës në datën 1.11.2016, në “Intesa Sanpaolo Bank”, depozitë në emër të motrës E.B., por hapur në emër të tij, duke qenë se e motra jeton në Angli dhe është emigrante e paligjshme. Pjesa takuese: 0 %. Në pyetësorin standard, subjekti ka deklaruar se personi i lidhur K.B. ka pasur deri në gusht të vitit 2019 depozitë bankare dhe llogari rrjedhëse në “Intesa Sanpaolo Bank”, ku asnjëra prej tyre nuk ishte në pronësi të tij, në kuptim të të ardhurave/valutës që ndodheshin në to. Lidhur me llogarinë rrjedhëse në lekë, subjekti ka deklaruar se përbëjnë të ardhura nga likuidimi i depozitës në datën 1.11.2016, ose interesat e fituara nga depozita e sipërcituar e motrës së bashkëshortit E.B. Edhe kjo llogari nuk ka qenë në pronësi të bashkëshortit, por ka qenë vetëm mbajtës, ku vlera në përqindje e tij ka qenë gjithmonë 0 %.

99. Sipas dokumentacionit të administruar nga “Intesa Sanpaolo Bank”⁴⁷, konfirmohet se në llogarinë nr. *** janë gjeneruar interesa bankare në vlerën 136.373 lekë gjatë vitit 2015 dhe në vlerën 194.931 lekë gjatë vitit 2016 dhe, për rrjedhojë, konfirmohet se burimi

⁴⁶ Vërtetim, datë 24.1.2017, nga “Intesa Sanpaolo Bank”, i cili vërteton se shtetasi K.B. ka llogari rrjedhëse nga interesa bankare të ardhura nga likuidimi i depozitës në datën 1.11.2016, në vlerën 194.588 lekë. Gjithashtu, ky shtetas ka llogari rrjedhëse në vlerën 0.32 GBP.

⁴⁷ Shkresë nr. *** datë 20.1.2020.

i gjendjes së llogarisë rrjedhëse në datën 28.1.2017, në vlerën 194.588,57 lekë, janë interesat bankare të depozitës.

100. Referuar arsytimit në lidhje me llogarinë e mostrës nga të cilat vijnë këto interesa, Komisioni nuk i konsideroi në analizën financiare të ardhurat nga interesat bankare. Në përfundim të hetimit të kësaj llogarie, Komisioni vlerëson se personi i lidhur me subjektin/bashkëshortin ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin këtë llogari dhe nuk ka konsideruar në analizën financiare të ardhurat nga interesat bankare, duke qenë se interesat janë të llogarisë depozitë me burim të ardhurat e mostrës së bashkëshortit.

12. Analiza financiare

101. Në deklaratën përpara fillimit të detyrës të vitit 2013, subjekti nuk ka deklaruar pasuri të paluajtshme, përveç atyre të fituara me trashëgimi. Po kështu, nga dokumentacioni i administruar nga bankat rezulton se në datën 30.9.2013 gjendja e likuiditeteve në llogaritë bankare të subjektit ka qenë -34.927 lekë. Për rrjedhojë, Komisioni kreu analizën financiare duke filluar nga tetori i vitit 2013.

102. Në pyetësin standard, në përgjigje të pyetjes së dytë, subjekti ka deklaruar se përgjatë periudhës tetor 2013 – tetor 2015 shpenzimet e saj të jetesës janë paguar nga të ardhurat nga pagat e saj, ndërkohë që nga data 10.10.2015 e në vijim shpenzimet e jetesës kanë qenë të përbashkëta me bashkëshortin dhe janë paguar nga të ardhurat e tyre.

103. Për sa më lart, Komisioni kreu analizën financiare, duke konsideruar pasuritë, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet: (i) për subjektin e rivlerësimit për periudhën tetor 2013 – shtator 2015; dhe (ii) për subjektin e rivlerësimit dhe personin e lidhur/bashkëshortin për periudhën tetor 2015 – dhjetor 2016, të paraqitur dhe të përmbledhur në vijim:

Tabela nr. 2 – Analiza financiare

Viti/Periudha	Pasuri	Ndryshim likuiditete <i>cash</i>	Ndryshim likuiditete bankë	Të ardhurat	Detyrimet	Shpenzime	Diferenca për shpenzime
Tetor - dhjetor 2013	0	0	35,256	173,269	0	110,256	27,757
2014	0	0	-47,421	1,192,835	0	394,998	845,258
Janar - shtator 2015	0	0	-20,748	821,973	0	168,207	674,514
Tetor - dhjetor 2015	420,420	0	25,129	725,379	200,000	427,203	52,628
2016	0	200,000	83,414	1,740,955	50,000	1,076,358	431,183
TOTAL	420,420	200,000	75,629	4,654,411	250,000	2,177,022	2,031,340

104. Referuar kontrollit vjetor të deklarimeve, pasurive, të ardhurave dhe shpenzimeve, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë pasur të ardhura nga burime të ligjshme për të krijuar pasuritë dhe për të kryer shpenzimet.

Konkluzioni i Komisionit mbi vlerësimin e pasurisë

105. Trupi gjykues, në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë, mbështetur në parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, vlerësoi se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë.

106. Komisioni, duke arsyetuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, në raport me provat e tjera të administruara nga Komisioni, nëpërmjet hetimit të tij, vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka arritur të argumentojë burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave të saj. Komisioni konkludon se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë.

107. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. Flojera Davidhi, ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të germës “a”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLLI I FIGURËS

108. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjekti të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuar në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar një raport me shkresën nr. *** prot., datë 30.10.2017, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 16.1.2020, të KDZH-së, për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.

109. Sipas këtij raporti, subjekti i rivlerësimit, znj. Flojera Davidhi: (a) ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklarimit për kontrollin e figurës; (b) ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara prej saj në deklaratën për kontrollin e figurës; (c) nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.

Si konkluzion, Grupi i Punës konstaton përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit znj. Flojera Davidhi.

110. Pavarësisht nga raporti i dërguar nga DSIK-ja, Komisioni ka kryer hetim administrativ, nga ku rezulton se: (i) nuk ka asnjë informacion apo *indicie* që të implikojë subjektin në kryerjen e ndonjë vepre penale apo cenim të figurës; (ii) nuk ka çështje penale apo kallëzim penal të filluar ndaj subjektit të rivlerësimit; (iii) nuk rezulton të jetë regjistruar ndonjë procedim penal për subjektin e rivlerësimit; (iv) nuk ka të regjistruar procedim penal, kallëzim penal apo të dhëna implikuese me persona të përfshirë në veprimtari kriminale në lidhje me subjektin e rivlerësimit, referuar të dhënave të administruara gjatë hetimit; (v) nuk ka denoncime apo të dhëna të tjera që të rezultojnë se subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuar në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016.

111. Konkluzion në lidhje me kontrollin e figurës – Subjekti i rivlerësimit, znj. Flojera Davidhi, ka plotësuar saktë deklaratën e kontrollit të figurës, nuk ka kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar, në kuptim të pikës 15, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016 dhe ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

C. RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

112. Sipas nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, relatori përgatit relacionin për vlerësimin e aftësive profesionale mbështetur në raportin e inspektorëve, informacionin e marrë nga burime të tjera, si dhe në kriteret e vlerësimit, të parashikuara në legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve dhe akteve të tjera ligjore.

113. Këshilli i Lartë Gjyqësor, si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka përgatitur një raport për vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit, znj. Flojera Davidhi. Ky raport ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të mëposhtme të vlerësimit: (a) aftësive profesionale; (b) aftësive organizative; (c) etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale; si dhe (ç) aftësive personale dhe angazhimit profesional.

114. Bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (i) formularit të vetëdeklarimit, të tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit; (ii) pesë dosjeve penale të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; si dhe (iii) të dhënat nga burimet arkivore të KLGJ-së.

115. Subjekti i rivlerësimit Flojera Davidhi, në periudhën janar 2011 – shtator 2011 ka kryer detyrën e sekretares gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë; në periudhën tetor 2011 – tetor 2013 ka kryer studimet në Shkollën e Magjistraturës; në periudhën tetor 2013 – korrik 2014 ka kryer stazhin profesional si kandidate për magjistrate në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë; në periudhën korrik 2014 – shtator 2015, në pritje të emërimit përfundimtar si gjyqtare; në periudhën shtator 2015 – më 11.10.2019 ka ushtruar detyrën e gjyqtares në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë. Me vendimin nr. *** datë 11.10.2019, është komanduar në pozicionin e këshilltares ligjore në Njësinë Mbështetëse të Komisioneve në Këshillin e Lartë Gjyqësor, ku vazhdon edhe aktualisht.

116. Analiza e gjetjeve i referohet të dhënave të nxjerra nga tri grupet e burimeve të informacionit: (i) formularit të vetëvlerësimit dhe dokumentacionit të paraqitur nga subjekti; (ii) pesë dosjeve të vëzhguara të përzgjedhura me short; si dhe (iii) të dhënave nga burimet arkivore në KLGJ, nga ku rezultoi se subjekti i rivlerësimit, znj. Flojera Davidhi, ka shfaqur aftësi shumë të mira në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit, është konstatuar se identifikon saktë normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Ka aftësi shumë të mira në arsyetimin ligjor. Vendimet gjyqësore janë arsyetuar qartë, qëndrimi i mbajtur lidhur me zgjidhjen në themel të çështjes jepet i argumentuar. Përmbajtja e vendimit është gjithëpërfshirëse dhe i jepet përgjigje ligjore pretendimeve apo prapësimeve/kundërshtimeve të palëve të parashtruara gjatë gjykimit.

117. Në dosjet e vëzhguara është konstatuar se subjekti i rivlerësimit ka respektuar afatet ligjore të gjykimit dhe arsyetimit në kohën e duhur të vendimeve gjyqësore, si dhe nuk janë konstatuar mangësi në aftësinë për të administruar dosjet. Referuar të dhënave

arkivore të KLGJ-së, rezulton se gjatë periudhës objekt rivlerësimi (tetor 2013 – tetor 2016) nuk është paraqitur asnjë ankesë ndaj subjektit në ish-Inspektoratin e KLD-së.

118. Hetimi i Komisionit – Komisioni kërkoi informacion pranë Ministrisë së Drejtësisë⁴⁸ dhe Këshillit të Lartë Gjyqësor⁴⁹ në lidhje me ankesat e paraqitura ndaj subjektit të rivlerësimit dhe masat disiplinore të marra ndaj saj, nga viti 2006 e deri më sot.

119. Pas administrimit të shkresës nr. *** prot., datë 19.4.2021, të Ministrisë së Drejtësisë, Komisioni vëren se ndaj subjektit Flojera Davidhi janë depozituar 4 ankesa: ankesa e shtetas N.P., e vitit 2018; ankesa e shtetasit P.Sh., e vitit 2018; ankesa e shtetasit T.H., e vitit 2019; dhe ankesa e shtetasit M.J., e vitit 2020. Për këto ankesa u vendos arkivimi i tyre, ku pas analizimit vlerësohet se pretendimet ngrihen mbi themelin e vendimit, i cili nuk është objekt shqyrtimi nga Komisioni.

120. Pas administrimit të shkresës nr. *** prot., datë 14.4.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, rezultoi se ndaj subjektit Flojera Davidhi janë depozituar tri ankesa: ankesa e shtetas N.P., e vitit 2018, për të cilën është vendosur arkivimi – lidhur me këtë ankesë vlerësohet se pretendimet ngrihen mbi themelin e vendimit, i cili nuk është objekt shqyrtimi nga Komisioni; dy ankesa të shtetasit T.H. të vitit 2019, të cilat nuk disponohen fizikisht pranë arkivës së institucionit, pasi janë depozituar në Inspektoratin e Lartë të Drejtësisë. Më tej, KLGJ-ja bën me dije se nuk rezultojnë të dhëna për procedime disiplinore apo masa të marra ndaj subjektit të rivlerësimit, znj. Flojera Davidhi.

121. Denoncime nga publiku – Në Komision, për subjektin e rivlerësimit, znj. Flojera Davidhi, janë administruar 6 denoncime nga publiku, si vijon: (i) denoncimi nr. *** prot., datë 12.2.2018, i shtetasit Th. Gj., i cili ankohet për dhënien e një vendimi të padrejtë; (ii) denoncimet nr. *** prot., datë 15.1.2019, dhe nr. *** prot., datë 24.7.2020, të shtetasit B. M., i cili ankohet për shkelje ligjore dhe procedurale të kryera nga subjekti i rivlerësimit; (iii) denoncimi nr. *** prot., datë 30.4.2019, i shtetasve T.H., I.R. dhe P.Sh., të cilët ankohen ndaj 10 subjekteve të rivlerësimit për dhënien e vendimeve të padrejta; (iv) denoncimi nr. *** prot., datë 11.9.2020, i shtetas F. M., e cila ankohet për disa subjekte rivlerësimi, ndër ta edhe subjekti Flojera Davidhi, pasi kjo e fundit nuk ka pranuar përjashtimin e ekspertit Y. N. gjatë shqyrtimit gjyqësor; (v) denoncimi nr. *** prot., datë 30.9.2020, i shtetasit K. M., i cili ankohet ndaj 10 subjekteve të rivlerësimit për dhënien e vendimeve të padrejta.

122. Komisioni, pasi mori në shqyrtim ankesat e mësipërme, konstaton se pretendohen fakte që kanë lidhje me korrektësinë e vendimeve dhe themelin e çështjeve të gjykuara nga subjekti i rivlerësimit, rrethana të cilat nuk mund të shqyrtohen nga Komisioni, sipas përcaktimit të pikës 2, të nenit E, fjalia e fundit, faqja 60 nga 64 e Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 4, të nenit 73, të ligjit nr. 96/2016. Në këto kushte, në mbështetje të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, vlerësohet se këto denoncime nuk përmbajnë fakte apo

⁴⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 6.4.2021.

⁴⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 6.4.2021.

rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit.

123. Më tej, nga hetimet e Komisionit, u vlerësuan si *indicie* informacionet e marra nga mediat *online* lidhur me rastin e gjyqimit të shtetases V. B., e cila akuzohej për veprën penale “korrupsion pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”. Komisioni, me shkresat nr. *** prot., datë 23.5.2021, dhe nr. *** prot., datë 23.5.2021, ka kërkuar administrimin e dosjeve gjyqësore pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë dhe Gjykatës së Apelit Korçë. Pasi analizimit të dosjeve gjyqësore⁵⁰, u konstatuan se:

123.1 Rrethana e çështjes – e pandehura V. B. ka qenë punonjëse pranë Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, me detyrë përgjegjëse hartografie. Në datën 8.10.2018 emisioni investigativ “****”, televizioni “****”, ka transmetuar faktin se kjo shtetase, në vendin e saj të punës ka marrë një shumë prej 20.000 lekësh nga shtetasi G. A. Prokuroria, në përfundim të gjyqimit, ka kërkuar deklarinim fajtores të të pandehurës V. B. për kryerjen e veprës penale “korrupsion pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal dhe dënimin e saj me 2 vjet burgim. Në aplikim të nenit 406/1 të Kodit Penal, dënimin përfundimisht me 1 vit e 6 muaj. Në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal, të pezullohet dënimi me burgim, duke u vënë e pandehura në provë. Shuarjen e masës së garancisë pasurore. Ndërkohë e pandehura dhe avokati i saj mbrojtës kërkuan pezullimin e dënimit me burg dhe detyrimin e të pandehurës të kryejë punë në interes publik për një periudhë prej 60 orësh.

123.2 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë ka konkluduar se fakti që i atribuohet të pandehurës nuk përmban elementet e veprës penale “korrupsion pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal dhe, për rrjedhim, në bazë të nenit 388 të Kodit të Procedurës Penale e pandehura duhet të deklarohet e pafajshme për veprën penale objekt akuze. Subjekti, në vendim nr. ***, datë 3.7.2019, arsyeton se duke marrë në analizë në mënyrë të hollësishme të gjithë elementet e anës objektive dhe subjektive, subjekti, në arsyetimin e vendimit të tij, vlerëson se veprimet e kryera në rastin konkret nga e pandehura nuk plotësojnë elementet e anës objektive të figurës së veprës penale për të cilën është vënë nën akuzë. Shkeljet e konstatuara janë të karakterit administrativ dhe etikës në punë. Gjykata e apelit, me vendimin nr. ***, datë 22.7.2020, ka lënë në fuqi vendimin e subjektit, duke arsyetuar se gjykata e shkallës së parë ka bërë një analizë tërësore të rrethanave dhe provave të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, ka vlerësuar me të drejtë se në raport me përmbajtjen e dispozitës penale, neni 259 i Kodit Penal, “Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, veprimet konkrete të kryera nga ana e të pandehurës në rastin konkret nuk përmbushin elementet e kësaj figure të veprës penale.

123.3 Komisioni pas analizimit të kësaj çështjeje, duke pasur parasysh: (i) ndjeshmërinë e publikut në rastet e korrupsionit të personave që ushtrojnë funksione publike, pamjet filmike të cilat vërtetojnë qartë marrjen e shumës monetare nga ana e të pandehurës; (iii) pretenca e prokurorisë; si dhe (iv) faktin që e akuzuara pranon akuzën dhe kërkoi një dënim më të lehtë, i kërkoi shpjegime subjektit në lidhje me

⁵⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 27.4.2021, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

vendimmarrjen e saj dhe arsytimit në vendim se fakti që i atribuohet të pandehurës nuk përmban elementet e veprës penale “korrupsion pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal.

123.4 Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet e saj me shkrim, por edhe gjatë seancës dëgjimore, deklaroi se pavarësisht se ndjekja penale ushtrohet nga ana e organit të akuzës, është gjykata ajo që jep vendim në bazë të provave që shqyrtohen dhe verifikohen në seancë gjyqësore, duke qenë organi i ngarkuar nga Kushtetuta për dhënien e drejtësisë, pra për fajësimin penal të të pandehurës në rastin konkret apo për shfajësimin e saj kur akuza nuk vërtetohet teç çdo dyshimi të arsyeshëm. Në zbatim të nenit 145/1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, gjykata nuk mund dhe nuk duhet të lidhet me kërkesat, vlerësimet dhe opinionet e palëve, por me atë që rezulton e provuar gjatë procesit gjyqësor. Nisur nga kjo, pavarësisht se e pandehura dhe avokati mbrojtës, në konkluzionet përfundimtare, kërkuan pezullimin e dënimit dhe aplikimin e dënimit alternativ, është gjykata ajo që vendos përfundimisht në bazë të provave. Subjekti, më tej deklaroi se e pandehura ka pranuar qenien në faj për veprimet e kryera, por jo fajësinë për veprën penale që i atribuohet. Deklarimi fajtor dhe dënimi penal i një të pandehuri vetëm mbi pranimin prej tij të fajësisë, për sa kohë veprimet e kryera dhe të pranuar nuk kualifikohen nga ligji penal si veprime të dënueshme, është i gabuar. Në përfundim, subjekti ka deklaruar se pavarësisht mënyrës së përcjelljes së këtij rasti në media, ka dhënë një vendim në përputhje me faktet e vërtetuara në gjykim, vendim i cili është i formës së prerë, çka nënkupton detyrimin e përgjithshëm për respektimin e tij.

123.5 Vlerësimi i Komisionit – bazuar në pikën 4, të nenit 72, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni analizon aftësitë gjyqësore pa gjykuar korrektesinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e gjyqtarit që vlerëson.

123.6 Trupi gjykues, pasi shqyrtoi shpjegimet e dhëna me shkrim dhe gjatë seancës dëgjimore, çmon se kjo çështje duhet të transferohet në bazë të pikës 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, pranë organit kompetent për inspektim për të verifikuar nëse evidentohen shkaqe që përbëjnë shkelje disiplinore, sipas ligjit për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë ose nëse ka shkaqe për t’u marrë parasysh gjatë vlerësimit periodik të subjektit të rivlerësimit. Ky konkluzion u arrit duke pasur në konsideratë fenomenin e korrupsionit në vendin tonë, ndjeshmërinë e publikut në këto raste dhe faktin nëse çështja në fjalë duket se mund të kishte pasur një trajtim edhe më ndëshkues për të pandehurën, e cila është kapur në flagrancë, duke marrë një shumë parash në zyrën e saj në këmbim të një shërbimi publik.

123.7 Pavarësisht sa më sipër, në raport me të gjitha çështjet e analizuara, rezultoi se subjekti shfaq aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit dhe në kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor, si dhe zotëron njohuritë ligjore dhe të arsytimit ligjor, referuar nenit 72 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

123.8 Komisioni vlerëson se çështja e transferuara në bazë të pikës 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, pranë organit kompetent për inspektim për të verifikuar nëse evidentohen

shkaqe që përbëjnë shkelje disiplinore, nuk është e mjaftueshme për ta kualifikuar subjektin e rivlerësimit si “me mangësi” apo “i papërshtatshëm” në drejtim të vlerësimit të kriterit të aftësisë profesionale, në kuptim të germave “b” dhe “c”, të nenit 44, të ligjit nr. 84/2016, pasi subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve, është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme.

124. Si konkluzion, Komisioni, në vlerësimin tërësor të kriterit të aftësive profesionale, vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. Flojera Davidhi, është “e aftë”, pasi ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve dhe është efiçiente në masë të pranueshme.

KONKLuzion PëRFUNDIMTAR

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, znj. Flojera Davidhi, ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- a. ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të germës “c”, të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.
- d.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Elka Ermenkova, referuar germës “a”, të pikës 1, të nenit 58 dhe pikave 1 dhe 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Flojera Davidhi, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë.
2. Në zbatim të pikës 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, të transferojë pranë organit kompetent për inspektim nëse evidentohen shkaqe që përbëjnë shkelje disiplinore çështjen me nr. regjistri themeltar 170/1255, përfunduar me vendimin nr. 373, datë 1.4.2019.

3. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë 30 ditë pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
4. Ndaj këtij vendimi, me përjashtim të pikës 2, mund të ushtrohet ankim pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisionerit Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.

Ky vendimi u shpall në datën 18.5.2021.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Pamela QIRKO
Kryesuese

Etleda ÇIFTJA
Relatore

Roland ILIA
Anëtar

Sekretare gjyqësore
Olsida Goxhaj